D E K R E T
Nr.7463, datë 31.1.1991

PËR POLICINË FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Policina financiare është organ ekzekutiv i armatosur e i specializuar për kontrollin e zbatimit të legjislacionit fiskal nga sektori shetëror e privat dhe nga personat fizikë dhe juridikë të huaj ose shqiptarë me seli jashtë territorit të RPSSH që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 2

Policia Financiare organizohet dhe drejtohet nga Ministria e Financave. Në ministrinë e Financave krijohet Drejtoria e Policisë Financiare kurse në rrethe e rajone krijohen degët e Policisë Financiare, të cilat japin llogari edhe para këshillave populllorë të rretheve e rajoneve dhe komiteteve ekzekutive të tyre.

Neni 3

Policia Financiare ka këto detyra:

a) të ushtrojë kontroll për pasqyrimin e drejtë e të saktë të të ardhurave e të rezultateve financiare nga veprimtaria që kryejnë personat fizikë e juridikë, vendas a të huaj ose shqiptarë me seli jashtë territorit të RPSSH, si dhe pagimin në afatet e caktuara të detyrimeve që rrejdhin nga sistemi fiskal i Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë;

b) të ushtrojë kontroll për zbatimin e drejt të rregullave të peshimit, të matjes, të standardeve, të çmimeve, të tarifave e të cilësisë së mallrave e të shërbimeve, për të mënjanuar përfitimet e padrejta;

c) të kontrollojë sistematikisht e të zbulojë ushtrimin e veprimtarive private pa leje, blerjen për shitje dhe të çdo lloj veprimtarie tjetër shitblerjeje pa leje të mallrave e sendeve me qëllim fitimi, si dhe të marrë masa për ndalimin e tyre e të mbajë procesverbal për shkeljet e vërejtura;

ç) të kontrollojë zbatimin e dispozitave të veçanta për monopolin e shtetit për prodhimin ose tregtimin e mallrave;

d) të kontrollojë zbatimin e dispoziatave në fushën e taksave doganore.

Neni 4

Policina Financiare ka këto të drejta:

a) të hyjë në çdo kohë në lokalet, njësitë e shitjes, të prodhimit, në ndërmarrje,

institucione, kooperativa për të verifikuar dhe për të marrë të dhëna për saktësinë e të adhurave e të fitimeve, mbi të cilat llogaritet tatimi, duke bllokuar paraprakisht, kur e sheh të domosdoshme, gjithë dokumentacionin që ka lidhje me këto veprimtari. Këtë të drejtë e ushtron edhe ndaj personave fizikë a juridikë të huaj ose shqiptar me seli jashtë territorit të RPSSH, që kryejnë veprimtari ekonomike në Republikën Populllore Socialiste të Shqipërisë;

b) të hyjë, me miratimin e prokurorit, në banesat ku dyshohet për ushtrimin e veprimtarive private pa leje, për blerjen, për shitje e të çdo lloj veprimtarie tjetër shitblerje pa leje të mallrave e të sendeve me qëllim fitimi dhe të mbajë proceverbal për shkeljet e vërejtura;

c) të bëjë kontrolle brenda dhe jashtë lokalit tregtar a të shërbimit, për pajisjen e blerësve me bileta për blerjen e mallit.

Neni 5

Janë kundërvajtje administrative:

a) ushtrimi i veprimtarisë private dhe i zejes e i profesionit pa leje;

b) veprimet që bëhen për të fshehur të ardhurat e fitimet e realizuara, mbi të cilat llogaritet tatimi, ose mospagimi në afatet e caktuara i detyrimeve që rrjedhin nga sistemi fiskal;

c) shkelja e rregullave të peshimit, të matjes, të standarteve, të çmimeve, të tarifave dhe të cilësisë së mallrave e shërbimeve;

ç) blerja për shitje dhe çdo veprimtari tjetër shitblerje pa leje të mallrave e të sendeve me qëllim fitimi;

d) shkelja e dispozitave në fushën e taksave doganore;

e) shkelja e dispozitave për monopolin e shtetit.

Shkeljet e mësipërme, kur nuk formojnë vepër penale, dënohen nga punonjësit e degës së policisë financiare të rrethit ose të rajonit dhe të Drejtorisë së Policisë Financiare në Ministrinë e Financave, me gjobë deri në 1000 lekë, si dhe me marrjen e mjeteve të punës, të lëndëve të para, të materialeve e produkteve të gatshme.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brena 5 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij, përkatësisht te kryetari i degës së policisë financiare të rrethit a të rajonit ose te Drejtori i i Drejtorisë së Policisë Financiare në Ministrinë e Financave, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 6

Policia financiare, për kryerjen e detyrave të saj, bashkëpunon me organet e policisë popullore.

Neni 7

Policia financiare ka uniformën, pajisjet dhe armatimin që përcaktohen nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendëshme.

Neni 8

Në shërbim të policisë financiare pranohen shtetasit që kanë kryer shërbimin ushtarak dhe, si rregull, kanë arsim ekonomik.

Neni 9

Rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij dekreti caktohen me dispozita të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIZ ALIA